V E N D I M
Nr.69, datë 15.2.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.321, DATË 5.7.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE, SIPAS RRETHEVE, PROCEDURAT E MIRATIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË DHE KUSHTET E DHËNIES SË KREDISË, NË KUADRIN E KREDISË GREKE PËR STREHIM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8448, datë 25.1.1999, "Për ratifikimin e kredisë greke për programin e strehimit", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Diferencat në fonde që mund të rezultojnë, sipas ndarjes së përcaktuar në lidhjen nr.1, në blerje, do të përdoren nga Enti Kombëtar i Banesave po për blerje banesash në tregun e lirë, me miratimin e Ministrisë së Punëve Publike.".

2. Pas pikës 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Enti Kombëtar i Banesave, pas marrjes në dorëzim të apartamenteve, të ndërtuara ose të blera, i merr ato në pronësinë e vet dhe lidh me përfituesit kontratat e shitblerjes me kusht kreditimi.".

3. Pika 7, paragrafi i parë dhe dy kushtet e para të dhënies së kredisë ndryshohen si vijon:

"Familjet përfituese të kredisë marrin në dorëzim apartamentin nga Enti Kombëtar i Bensave vetëm pasi të kenë lidhur marrëveshjen e kredisë me Bankën e Kursimeve, si agjente e Qeverisë shqiptare për zbatimin e marrëveshjes së kredisë. Përfituesi i kredisë i nënshtrohet rregullave të Bankës së Kursimeve për shlyerjen e saj.

Kushtet e dhënies së kredisë janë:

- Afati i shlyerjes së kredisë 20 vjet.
- Interesi vjetor i kredisë është 7 për qind, në monedhën lek shqiptar.".

(Kushtet e tjera nuk ndryshojnë).

4. Pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

"7/1. Familjet që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën e mësipërme, nuk gëzojnë të drejtën e përfitimit të banesës.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta